

**VENDIM**

Nr. 259, datë 29.3.2017

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 681, DATË 28.9.2016, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI
I SEGMENTIT RRUGOR
“TIRANË–ELBASAN (RRËSHQITJA
NË FSHATIN IBË)””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen

në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tabelën bashkëlidhur vendimit nr. 681, datë 28.9.2016, të Këshillit të Ministrave, të dhënat e pronarit dhe të pasurisë në nënndarjen nr. 4 ndryshohen sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

**LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË SEGMENTIT RRUGOR
“TIRANË - ELBASAN (RRËSHQITJA NË FSHATIN IBË)”**

Nr.	PRONARI	ZK	Nr. pas.	Lloji i pasurisë	Sip. totale	Vlerësimet			Kultura bujqësore e drufrutorë	Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emri i pronarit					Sip (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)			
4	Osman Shaban Bunaca	2735	22/14	Arë	6500	248	399	98952		98952	Konfirmim nga ZVRPP-ja